



ISH-PRESIDENTI I KOSOVËS, HASHIM THAÇI, KA QËNDRUAR TË ENJTEN DISA ORË NË PRISHTINË. AI KA VIZITUAR BABANË NË QKUK, I CILI ËSHTË NË GJENDJE TË RËNDË SHËNDETËSORE

THAÇI VIZITON TË ATIN NË QKUK, QYTETARËT E NDEROJNË NË OBORR

FAQE 3



Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, e ka vizituar të enjten babanë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) në Prishtinë, në të cilën ai është duke u

mjekuar prej kohësh, pasi mori leje nga Dhomat e Specializuara të Kosovës me seli në Hagë. Për disa orë Thaçi pati mundësi ta vizitojë babanë në Klinikën Interne. Arritja e ish-

presidentit të Kosovës në Prishtinë është realizuar me masa të rrepta sigurie. Thaçi në Kosovë është pritur me entuziazëm të madh nga qytetarët në oborrin e QKUK-së f

AKTUALE



KËRCËNIMI I FSHEHUR I SPIUNAZHIT: PËRPJESJE PËR TA BËRË KOSOVËN "JOFUNKSIONALE" F. 4

NDALIMI I RRJETIT 'TIKTOK' NË SHQIPËRI, EKSPERTËT: VETËM KJO MASË NUK MJAFTON F. 5

AKSIDENTOHET AUTOBUSI ME NXËNËS NË VUSHTRRI, VDES SHOFERI F. 6

EKONOMI



"15 MARS, KOSOVA BOJKOTON TË GJITHA SUPERMARKETET" F. 8

ÇMIMET NË "QIELI", QYTETARËT ANKOHEN PËR SHTRËNJTIMIN E PERIMEVE F. 8

SPORT



KAMPI NACIONAL NË HAJVALI DO TË BËHET ME 14 MIJË ULËSE F. 6

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Trumpi e kërcënon BE-në me 200 % tarifë ndaj alkoolit, pasi ajo propozoi tarifë ndaj uiskit amerikan

WASHINGTON, 13 MARS - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, e ka kërcënuar Bashkimin Evropian se do të vendosë 200 për qind tarifë ndaj verës, shampanjës dhe pijeve të tjera alkoolike evropiane nëse blloku e zbaton tarifën e propozuar ndaj uiskit amerikan. Tarifa, të cilën BE-ja tha se po e vendos si kundërmasë kundër tarifave të administratës amerikane ndaj aluminit dhe çelikut, pritet të zbatohet nga 1 prilli. Por, Trumpi u zotua të enjten për përshkallëzimin e luftës tregtare, nëse BE-ja nuk heqë dorë nga synimi i saj për vendosjen e tarifës prej 50-përqindësh ndaj uiskit amerikan. “Nëse kjo tarifë nuk hiqet menjëherë, ShBA-ja do ta vendosë shpejt një tarifë prej

200-përqindësh ndaj të gjitha verërave, shampanjës dhe produkteve alkoolike që vijnë nga Franca dhe vendet e tjera të BE-së”, shkroi Trumpi në rrjetet sociale. “Do të jetë shumë mirë për biznesin e verës dhe shampanjës në ShBA”, shtoi ai. Presidenti republikan la të kuptohej të mërkurën se e ka ndër mend ta ndërmarrë një veprim të tillë. “Natyrisht se do të përgjigjem”, tha Trumpi për gazetarë në Zyrën Ovale të mërkurën. Trumpi, duke njoftuar për tarifafat ndaj aluminit dhe çelikut të mërkurën, i sfidoi haptazi aleatët e ShBA-së dhe u zotua se do ta rikthejë pasurinë e “vjedhur” nga vendet e tjera. Ai ka vendosur tarifa ndaras ndaj Kanadasë, Meksikës dhe Kinës, dhe ka ndër mend të vendosë taksa ndaj importeve



nga Bashkimi Evropian, Brazili dhe Koreja e Jugut, duke vendosur tarifa “reciproke” nga 2 prilli. Tarifafat e ShBA-së prekin

tregtinë në vlerë 25.6 miliardë euro në BE, ndërsa blloku u përgjigj me një paketë masash në vlerë të përgjithshme prej 26 miliardë eurosh ndaj mallrave

amerikane të cilat do të vendosen në dy faza. Faza e parë, nga 1 prilli, godet produktet klasike amerikane, si uiski burbon, xhinse, dhe motoçikleta Harley-Davidson, të gjitha këto në vlerë të 8 miliardë eurove. Pakoja e dytë e tarifave, e propozuar të futet në fuqi më 13 prill, duhet ta marrë pëlqimin e shumicës së kualifikuar të vendeve anëtare të BE-së. Kjo pako prek mallrat si, produktet bujqësore, tekstilin, pajisjet shtëpiake dhe plastiken, në vlerë të përgjithshme prej 18 miliardë eurove. Diplomatat me të cilët ka folur Radio Evropa e Lirë besojnë se ekziston një shumicë e tillë, pasi blloku është bërë gjithnjë e më i zemëruar me administratën amerikane.

Kremlini thotë se refuzon çdo armëpushim të përkohshëm me Ukrainën

MOSKË, 13 MARS - Një ndihmës i lartë i presidentit rus Vladimir Putin ka refuzuar çdo armëpushim të përkohshëm me Ukrainën disa orë para se një delegacion amerikan të mbërrinte në Rusi për bisedime me Moskën, ku ata do t'i bëjnë thirrje Kremlinit të pajtohet me propozimin për një armëpushim 30-ditor ose në të kundërtën do të përballen me sanksione. Ndihmësi i Kremlinit, Yuri Ushakov, në një intervistë për televizionin shtetëror rus, tha më 13 mars se propozimi i presidentit amerikan Donald Trump, që Kievi e ka pranuar, vetëm do t'i jepte kohë Ukrainës që të rimëkëmbet nga presioni që Rusia i ka bërë ndaj trupave të saj. “E kam paraqitur qëndrimin tonë se kjo nuk është asgjë më shumë sesa një pushim për ushtrinë ukrainase, asgjë më shumë”, tha Ushakov, i cili për më shumë se gjysmëshekulli është i përfshirë në diplomaci



dhe konsiderohet se është këshilltari kryesor i politikës së jashtme të Kremlinit. Ai shtoi se qëndrimin e Moskës ia ka paraqitur këshilltarit për siguri kombëtare të ShBA-së, Mike Waltz, gjatë një bisede telefonike të zhvilluar një ditë më parë. “Më duket se askush nuk ka nevojë për hapa që

imitojnë veprime paqësore në këtë situatë”, tha ai, duke theksuar se Rusia dëshiron një zgjidhje afatgjatë që adreson interesat dhe e saj dhe merr parasysh shqetësimet e Moskës. Gjatë një takimi në Shtëpinë e Bardhë më 12 mars me kryeministrin irlandez Micheal Martin, presidenti

Trump shprehu bindjen lidhur me arritjen e një armëpushimi për Ukrainën dhe tha se negociatorët amerikanë “janë nisur drejt Rusisë”. Ndërkaq, të enjten zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, konfirmoi se ekipi amerikan raportohet se kryesohet nga i dërguari i posaçëm i Trumpit, Steve Witkoff. Agjencia shtetërore e lajmeve, TASS, raportoi më vonë se Witkoff ka mbërritur në Moskë. Paraprakisht, Trumpi u ka thënë gazetarëve se Rusia “nuk ka zgjidhje tjetër” përpos armëpushimit. Ai tha se nuk e përjashton mundësinë e vendosjes së sanksioneve nëse Moska e refuzon armëpushimin, por shtoi se shpreson që të mos jetë e nevojshme. Presidenti amerikan e ka bërë prioritet kryesor përfundimin e pushtimit rus të Ukrainës qëkur ka marrë mandatin e dytë presidencial më pak se

dy muaj më parë, duke bërë përpjekje diplomatike me një rritëm të shpejtë. Deklaratat e tij të fundit vijnë pasi Kievi u pajtua me planin amerikan për një armëpushim të përkohshëm, pas bisedimeve që zgjatën nëntë orë në Arabinë Saudite mes delegacionit ukrainas dhe atij amerikan. Delegacionet ukrainase dhe amerikane diskutuan edhe për rëndësinë e përpjekjeve humanitare si pjesë e procesit të paqes, veçmas gjatë armëpushimit, përfshirë këmbimin e të burgosurve të luftës, lirinë e civilëve të arrestuar dhe kthimin e fëmijëve ukrainas të zhvendosur me forcë. Më pas, Trumpi deklaroi se përfaqësuesit amerikanë dhe rusë do të takoheshin për të diskutuar për armëpushimin. Pas negociatave, ShBA-ja nisi ndihmën ushtarake dhe ndarjen e informacioneve të inteligjencës me Ukrainën.

Austria anulon bashkimin familjar

VJEN, 13 MARS - Azilkërkuesit në Austri nuk do të kenë më të drejtë t'i tërheqin pjesëtarët e afërt të familjes. Ashtu siç edhe e kishin paralajmëruar, tri partitë e koalicionit të ri qeverisës në Vjenë kanë vendosur mbylljen e praktikës së njohur të bashkimit familjar. Kabineti qeveritar ra dakord me këtë ndryshim kyç në Ligjin e Azilit, i cili tashmë do të kalojë për votim në Këshillin Kombëtar, pastaj në

parlament. Kancelari Christian Stocker i partisë popullore konservatore (ÖVP) e argumentoi këtë hap, me tejkallimin e kapaciteteve pranuese të Austrisë - veçanërisht në sektorin e arsimit ka mbingarkesë. “Në vitet 2023 dhe 2024 në kuadrin e bashkimit familjar në Austri kanë hyrë gjithsej 18 000 persona, ndër ta 13 000 minorenë në moshë të detyrimit shkollor. Në sfondin

e këtyre shifrave është e kuptueshme që ne duhet të veprojme konform përgjegjësisë sonë dhe t'i vendosim frenat për një periudhë të caktuar”, tha Stocker. Nisma, megjithatë, shihet ligjërisht e diskutueshme, pasi zërat kritikë argumentojnë se ajo përbën shkelje ndaj së drejtës së azilit sipas Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.





ISH-PRESIDENTI I KOSOVËS, HASHIM THAÇI, KA QËNDRUAR TË ENJTEN DISA ORË NË PRISHTINË. AI KA VIZITUAR BABANË NË QKUK, I CILI ËSHTË NË GJENDJE TË RËNDË SHËNDETËSORE

THAÇI VIZITON TË ATIN NË QKUK, QYTETARËT E NDEROJNË NË OBORR

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, e ka vizituar të enjten babanë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) në Prishtinë, në të cilën ai është duke u mjekuar prej kohësh, pasi mori leje nga Dhomat e Specializuara të Kosovës me seli në Hagë. Për disa orë Thaçi pati mundësi ta vizitojë babanë në Klinikën Interne. Arritja e ish-presidentit të Kosovës në Prishtinë është realizuar me masa të rrepta sigurie. Thaçi në Kosovë është pritur me entuziazëm të madh nga qytetarët në oborrin e QKUK-së

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 13 MARS - Gjykata Speciale i ka lejuar të enjten ish-presidentit Hashim Thaçit një vizitë humanitare në Kosovë për të parë babanë e tij i cili është në gjendje të rëndë shëndetësore. Për disa orë Thaçi pati mundësi ta vizitojë të atin në Klinikën Interne në QKUK. Arritja e ish-presidentit të Kosovës në Prishtinë është realizuar me masa të rrepta sigurie. Te Klinika Interne e QKUK-së, ku është i shtrirë babai i Thaçit, ish-presidenti është sjell nga një eskortë e veturave të EULEX-it dhe nga një numër i madh i policëve. Ardha e Thaçit në Kosovë është

pritur me entuziazëm të madh nga qytetarët. Publikimi i lajmit për ardhjen e tij bëri që shumë qytetarë të mblidhen para klinikës ku do të hynte ish-presidenti i Kosovës. Dalja nga makina dhe ngjitja shkallëve të klinikës u përcoll me ovacione nga qytetarët. Derisa këta të fundit thërrisnin emrin e tij dhe të UÇK-së, ish-presidenti ngrinte dorën lart dhe i përshëndeste. Derisa kërkesat e mëparshme i ishin hedhur poshtë, Dhomat e Specializuara të Kosovës njoftuan se ia pranuan kërkesën për të qenë pranë prindit të enjten, “për arsye të fuqishme humanitare”. “Trupi Gjykues dhe Gjyqtari i Procedurës Paraprake kanë udhëzuar Regjistrin të

organizojë një vizitë paraburgimi në Kosovë për Hashim Thaçin që të jetë pranë babait. Gjatë kësaj vizite i akuzuari mbetet në paraburgim dhe në kujdestarinë e Dhomave të Specializuara”, thuhet në njoftimin e gjykatës. Thaçi ka shprehur gatishmëri për t'i respektuar të gjitha

masat e Gjykatës Speciale, vetëm që ta realizojë vizitën për ta parë babanë. Thaçi po përballlet me dy procese gjyqësore në Gjykatën Speciale në Hagë dhe është në paraburgim në qytetin holandez prej vitit 2020. Në rastin e parë Thaçi akuzohet kinse për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, bashkë me

ish-zyrtarë të tjerë të lartë të Kosovës, si Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi. Vitin e kaluar ndaj Thaçit u ngrit një aktakuzë e re për përpjekje të paligjshme për të ndikuar në dëshmitë e dëshmitarëve në rastin e parë gjyqësor. Thaçi është deklaruar i pafajshëm në dy rastet gjyqësore.





KËRCËNIMI I FSHEHUR I SPIUNAZHIT: PËRPJEKJE PËR TA BËRË KOSOVËN ‘JOFUNKSIONALE’

Spiunazhi është një kërcënim serioz për sigurinë e Kosovës dhe arrestimet e fundit vetëm se nxjerrin në pah rrezikun e vazhdueshëm, thonë ekspertët. Sipas tyre, ky aktivitet jo vetëm që destabilizon vendin brendapërbrenda, por dëmton edhe pozitën e tij ndërkombëtare. Institucionet, në anën tjetër, janë kryesisht të heshtura për përmasat e problemit

PRISHTINË, 13 MARS - Ish-kryeinspektori i Agjencisë Kosovare të Inteligjencës (AKI), Burim Ramadani, e konsideron spiunazhin një prej kërcënimeve kryesore të sigurisë kombëtare në vend. Arrestimet e fundit, por edhe procedurat e tjera penale kundër disa të dyshuarve, tregojnë, sipas tij, se sa e cenueshme është Kosova ndaj aktiviteteve të tilla të inteligjencës së huaj. “Dëmet që synohen të shkaktohen janë ato që e nxjerrin Kosovën keq jashtë dhe e vendosin atë nën tension përbrenda”, thotë Ramadani për Radion Evropë e Lirë. Më 28 shkurt të këtij viti nën dyshimet për spiunazh u arrestua Jellena Gjukanoviq nga komuniteti serb në veri të Kosovës. Punonjëses së Misionit të OSBE-së në Prishtinë iu

shqiptua masa e paraburgimit prej 30 ditësh më 2 mars. Disa media shkruan se ajo ishte spiune e Agjencisë serbe të Zbulimit - BIA por, përkundër përpjekjeve, Radio Evropa e Lirë nuk arriti t’i konfirmonte në mënyrë të pavarur këto raportime. REL-i mësoi përmes prokurorit të Prokurorisë Speciale të Kosovës, Bekim Kodraliu, se provat nga një rast tjetër e inkriminuan edhe Gjukanoviqin. Kodraliu tha se nuk mund të japë më shumë detaje për shkak të hetimeve që vazhdojnë, por theksoi se rasti është duke u trajtuar si “i ndjeshëm”. Tri ditë pasi që gjykata ia shqiptoi masën e paraburgimit Gjukanoviqit, ishte planifikuar të mbahej seanca fillestare për dy të dyshuar të tjerë për

spiunazh, Bedri Shabanin dhe Muharrem Qerimin, por ajo u shty për 17 mars. Të dy ata akuzohen se kanë ndarë informacione dhe materiale të ndryshme me BIA-n. Spiunazhi është veprimtari e fshehtë e mbledhjes, transferimit ose shpërndarjes së informacioneve të ndjeshme të një shteti, organizatë apo grup tjetër. Me Kodin Penal të Kosovës, spiunazhi konsiderohet krim i rëndë dhe dënohet me minimum pesë vjet burg, nëse konfirmohet fajësia.

Institucionet kryesisht heshtin

I kontaktuar nga Radio Evropa e Lirë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës tha se, së paku në tre vjetët e fundit, nuk ka asnjë rast me epilog të zgjidhur që ka të bëjë me spiunazhin. Pavarësisht prej insistimit të REL-it, ai nuk dha ndonjë informacion se sa procese gjyqësore janë në zhvillim e sipër ndaj personave të akuzuar për spiunazh. Interesimit të Radios Evropa e Lirë lidhur me numrin e rasteve të hetuara dhe procedura për veprën e spiunazhit nuk iu përgjigj as Prokuroria Speciale e

Kosovës e as Policia e Kosovës. Ngjashëm, as Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e Kosovës nuk iu përgjigj pyetjes se sa persona janë shpallur “non grata”, apo të padëshirueshëm, në pesë vjetët e kaluar, për shkak të kërcënimit të sigurisë kombëtare. Vitet e fundit janë shpallur disa të tillë dhe janë dëbuar.

“Pikat e ndjeshme” të spiunazhit

Ish-kryeinspektori i AKI-së, Ramadani, thotë se aktivitetet e spiunazhit në Kosovë kanë disa qëllime: dëmtimin e mënyrës së vendimmarrjes brenda institucioneve të Kosovës, shtrembërimin e së vërtetës së Kosovës dhe të proceseve të saj, si dhe ndikimin në infrastrukturën kritike apo vitale të sigurisë. Aktivitetet e tilla, sipas tij, synojnë edhe të orientojnë ose shpërqendrojnë vëmendjen e opinionit publik nga tema që ndërlidhen ose jo me interesin e sigurisë kombëtare të Kosovës. Por, për shkak të ndjeshmërisë së tyre dhe ruajtjes së fshehtësisë, ai thotë se nuk mund t’i specifikojë veprimet që kanë derivuar nga aktivitetet e

spiunazhit, e as pikat ku është sulmuar Kosova. Ramadani thotë vetëm se struktura të Serbisë - “të trajnuara, të monitoruara dhe të mentoruara nga strukturat e spiunazhit rus” - kanë për qëllim ta bëjnë Kosovën jofunksionale si shtet. “Ka pasur raste kur një shtetas rus, për shembull, është zënë dhe është kapur në flagrancë, duke iu prirë barrikadave në veri të Kosovës... dhe pastaj është shpallur ‘non grata’ nga Qeveria e Republikës së Kosovës”, thotë Ramadani. “Dëmet janë jashtëzakonisht të vështira për t’u matur”, sipas tij. Serbia, edhe 17 vjet pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, vazhdon ta konsiderojë atë si pjesë të territorit të saj. Me mbështetjen e Rusisë lufton edhe kundër anëtarësimit të Kosovës në organizata të ndryshme ndërkombëtare, si Këshilli i Evropës, Interpol-i, apo UNESCO-ja. Për ish-zëvendësministrin e Brendshëm të Kosovës, Valdet Hoxha, janë kryesisht Serbia dhe Rusia ato që kanë apetite për ta nxjerrë Kosovën si “projekt të dështuar të Perëndimit”. “Në këtë kontekst, natyrshëm, ato kanë synuar

NDALIMI I RRJETIT ‘TIKTOK’ NË SHQIPËRI, EKSPERTËT: VETËM KJO MASË NUK MJAFTON

Mbyllja e platformës ‘TikTok’ nuk do ta zgjidhë problemin e të rinjve shqiptarë, mendojnë ekspertët. Kjo masë e marrë nga qeveria shqiptare për një periudhë 12-mujore synon shmangien e ndikimeve negative të kësaj platforme online dhe rritjen e sigurisë së fëmijëve. Mijëra prindër e kanë mbështetur vendimin, të tjerë thonë se vetëm kjo masë nuk mjafton

TIRANË, 13 MARS - Në Shqipëri autoritetet kanë vendosur ta mbyllin rrjetin social ‘TikTok’ për një periudhë 12 mujore si pjesë e masave të përkohshme, sipas tyre, për shmangien e ndikimeve negative të kësaj platforme online dhe rritjen e sigurisë së fëmijëve në mjedisin digjital. Autoritetet morën këtë vendim pasi zhvilluan 1 300 takime me

rreth 65 mijë prindër në të gjithë vendin. Kufizimi i rrjetit ‘TikTok’ ndodhu pasi një adoleshent goditi me thikë për vdekje një adoleshent tjetër në muajin nëntor të vitit të kaluar pas një sherri që filloi në këtë platformë online. Drejtoresha e shkollës “Petro Nini Luarasi” në Tiranë thotë se shumica e prindërve e

mbështesin këtë masë. “Më shumë se 90 për qind e prindërve kanë qenë shumë dakord për këtë hap. Besoj se ata kanë nevojë për një lloj ndihme, mbështetje për të kufizuar dhe monitoruar këtë kohë të harxhuar kot në një farë mënyre”, thotë Elsa Sheqi. Sipas studiueseve në vend, fëmijët shqiptarë përbëjnë grupin më të madh të përdoruesve të rrjetit ‘TikTok’. 17-vjeçarja Patris Lole thotë se masa për ta ndaluar këtë platformë do të ketë ndikim. “Mendoj se është një vendim që shkon paralelisht me mënyrën se si jemi rritur, me mënyrën se si janë rritur fëmijët në Shqipëri. Ne jemi shumë të orientuar nga media. Pra, gjatë gjithë kohës ne kemi pasur telefona dhe kompjuterë në dorë. Pra, ‘TikTok’-u ka qenë gjithmonë një mjet për ne që të shprehemi. Por vjen një kohë kur edhe gjërat më të bukura

duhet të marrin fund”. Babai i 17-vjeçares nuk beson se ndalimi i ‘TikTok’-ut do t’i japë zgjidhje problemit. “Le ta mbyllin, le ta testojnë, por asgjë nuk do të zgjidhet”, thotë Nolja Lole. Ekspertët tregojnë për shumë platforma të tjera të medieve sociale të cilave do t’u drejtohen të rinjtë kur të mbyllet ‘TikTok’-u. Ata thonë se përgjigjja qëndron në adresimin e problemeve psikologjike dhe izolimit. “Për mendimin tim, nuk do t’i zgjidhë problemet që kanë me mungesën e interesit për të mësuar, mungesën e motivimit për shkollën, mungesën e besimit në të ardhmen që do të ndryshonte përmes shkollës, mungesën e solidaritetit mes njëri-tjetrit nga e cila po vuajnë, sepse i shohim çdo ditë më të izoluar, më të brishtë psikologjikisht. Të gjitha këto probleme janë të lidhura me

mësimin e tyre, njohuritë, rezultatet e dobëta në teste, rezultatet e dobëta të lidhura me varfërinë e kështu me radhë. Besoj se këto janë problemet e vërteta për të miturit tanë, për adoleshentët tanë që kanë nevojë për masa më të gjera qeverisëse, më të thella, sesa hapa të tillë të mbylljes së ‘TikTok’-ut që duket shumë periferike në morinë e problemeve me të cilat përballen”, thotë Entela Binjaku, sociologe. Qeveria shqiptare është në kontakt me platformën ‘TikTok’ për instalimin e filtrave si kontrolli prindëror, verifikimi i moshës dhe përfshirja e gjuhës shqipe në aplikacion. Por ajo që për qeverinë është një masë për t’i mbrojtur fëmijët dhe adoleshentët nga rreziqet e mjedisit digjital, nga ana tjetër është për opozitën një akt censure që merret në kulmin e fushatës zgjedhore.



infiltrimin e njerëzve të tyre në mekanizmat e sigurisë, në mekanizmat e tjerë politikë”, thotë Hoxha për Radion Evropa e Lirë. Megjithatë, ai shton se dëbimi nga Kosova i disa personave të cilësuar si “non grata” apo të padëshirueshëm, tregon se autoritetet e Kosovës dhe strukturat e saj të sigurisë kanë informata për rrezikun e mundshëm nga spiunazhi. “Dhe, nuk mund të jemi komod, sepse Kosova është një qendër e vlimit të situatës në rajonin e Ballkanit [Perëndimor], thekson ai për Radion Evropa e Lirë.

A ka Kosova kapacitete për luftimin e spiunazhit?

Ndonëse nuk është imune ndaj rrjeteve dhe veprimeve të spiunazhit, Kosova ka përparuar në vazhdimësi në konsolidimin e sektorit të sigurisë, përfshirë këtu edhe mekanizmat institucionalë kundër spiunazhit, vlerësojnë të dy ekspertët e çështjeve të sigurisë. Ramadani thotë se ky konsolidim është jashtëzakonisht i dukshëm tek institucionet e sigurisë, përfshirë AKI-në, por shton se

do të duhej të zgjerohej edhe me një qasje më gjithëpërfshirëse në raport me institucionet e tjera. Ai thotë se institucionet e sigurisë në Kosovë kanë fituar edhe besimin dhe mbështetjen e organizatave të sigurisë nga shtetet tjera. “Ka pasur raste kur institucionet e sektorit të sigurisë i kanë falënderuar edhe publikisht shtetet partnere për mbështetje në raste specifike, për shkëmbim të informacioneve dhe trajtim të atyre informacioneve, të cilat kanë rezultuar, pastaj, qoftë me ndërprerje të një aktiviteti

armiqësor të spiunazhit, qoftë me shpallje ‘non grata’ të personave të përfshirë në spiunazh, apo me arrestime dhe procedim penal”, thotë Ramadani, por nuk specifikon më shumë. Hoxha thotë se ky bashkëpunim ka bërë që institucionet e sigurisë në Kosovë të kenë rritje të qëndrueshme, e sidomos AKI-ja. Sipas tij, kjo agjenci është “ndër më të përgatiturat në rajon”, por kjo nuk do të thotë se Kosova duhet të jetë më pak vigjilente. “Spiunazhi është veprimtari tinëzare dhe

veprimtari që bëhet me plan të detajuar dhe të mbështetur fuqishëm nga shërbimet inteligjente [armiqësore]”, thekson Hoxha. Në kontekstin e zhvillimeve gjeopolitike, të dy ekspertët paralajmërojnë se mund të ketë veprimtari edhe më agresive të spiunazhit kundër Kosovës. Ndaj, theksojnë ata, forcimi i mëtejshëm i mekanizmave të sigurisë dhe bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë mbeten çështje thelbësore për t’i parandaluar dhe neutralizuar kërcënimet që vijnë nga spiunazhi.

Konjufca takon ambasadorin e Irlandës, diskutojnë rreth aktualitetit në Kosovë

PRISHTINË, 13 MARS - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të enjten në takim ambasadorin Jorezident të Irlandës për Kosovën, Ragnar Almqvist. Duke e falënderuar për vizitën, Konjufca i shprehu mirënjohje ambasadorit Almqvist për mbështetjen e Republikës së Irlandës ndaj Republikës së Kosovës.

Në këtë takim bashkëbiseduesit diskutuan rreth aktualitetit në Kosovë e më gjerë, për marrëdhëniet tona bilaterale dhe për nevojën e thellimit të mëtejshëm të bashkëpunimit mes vendeve tona. Konjufca ka theksuar se Kosova mbetet e përkushtuar në rrugën e saj të integritetit, të zhvillimit,

forcimit të mëtejshëm të demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Në këtë kuadër, kryekuvendari Konjufca nënvizoi se vazhdimi i mbështetjes së Irlandës për Kosovën vijon të jetë shumë i rëndësishëm dhe rikonfirmon partneritetin tonë që zhvillohet në bazë të vlerave dhe interesave të përbashkët.



REKTORI I UNIVERSITETIT TË NAPOLIT “L’ORIENTALE” VJEN NË UP PËR BASHKËPUNIM DHE LIGJËRATË

PRISHTINË, 13 MARS - Rektori i Universitetit të Napolit “L’Orientale”, Roberto Tottoli, bashkë me profesoreshat e këtij universiteti, Francesca Bellino dhe Blerina Suta, në një takim me rektorin Arben Hajrullahu dhe prorektorin Rozafa Basha, hulumtuan mundësitë e shtimit dhe thellimit të bashkëpunimit mes dy institucioneve të arsimit të lartë. Në takim ishin të pranishëm edhe dekani i Fakultetit të Filologjisë, Abdulla Rexhepi, prodekanja Milote Sadiku, si dhe akademiku dhe profesori i këtij fakulteti, Bardh Rugova.

Universiteti i Prishtinës ka pasur prej disa vitesh një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Napolit “L’Orientale”, e cila është përditësuar rishtazi. Duke u dëshiruar qëndrim të këndshëm në Kosovë, rektori Hajrullahu u tha miqve dhe kolegëve të tij italianë, se në të dy universitetet ka njerëz me vullnet për ta çuar përpara bashkëpunimin në fushat me



interes të përbashkët. Ai si shembull për lidhje të pashkëputshme mes dy shteteve e universiteteve përmendi historinë e përbashkët dhe komunitetin arbëresh, i cili prej shekujsh, që nga vdekja e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, jeton dhe ruan traditat në Itali.

Rektori i Universitetit të Napolit

“L’Orientale”, Roberto Tottoli, tha se ky universitet i shkencave humane me 10 mijë studentë e 700 persona të personelit, e ka çështje shumë të rëndësishme rritjen e bashkëpunimeve ndërkombëtare.

Duke u lidhur me bashkëjetesën shekullore mes italianëve dhe shqiptarëve, rektori Tottoli tregoi se Katedra

e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në këtë universitet ekziston që nga viti 1900, edhe para se të ishte themeluar shteti shqiptar, ndërsa prorektorja për ndërkombëtarizim dhe shkëmbim akademik, Rozafa Basha, foli edhe për themelimin e Institutit për Gjuhë dhe Letërsi Italiane në Fakultetin e Filologjisë së UP-

së. Rektori Tottoli ka mbajtur ligjëratë në Fakultetin e Filologjisë për “Çetën e profetëve” të Pjetër Bogdanit dhe studimin e islamit dhe Kuranit në Evropë, ndërsa kolegja e tij Francesca Bellino do të ligjërojë në lidhje me veprimtaritë enciklopedike arabe gjatë periudhës osmane.

AKSIDENTOHET AUTOBUSI ME NXËNËS NË VUSHTRRI, VDES SHOFERI



VUSHTRRI, 13 MARS - Një automjet, që po transportonte nxënës, është aksidentuar paraditen e 13 marsit në Vushtrri, duke lënë të vdekur shoferin dhe duke lënduar disa nxënës.

Policia e Kosovës tha se aksidenti raportohet se ka ndodhur rreth orës 08:00 në fshatin Galicë të Vushtrrisë, duke shtuar se Shërbimi Spitalor Klinik Universitar

njoftoi disa orë më vonë se shoferi, 59 vjeç, ndërroi jetë si pasojë e lëndimeve të marra. Sipas autoriteteve, edhe shtatë persona të tjerë, që gjendeshin në automjetin e aksidentuar, janë lënduar gjatë këtij aksidenti trafiku. “Nga hetimet e para të zhvilluara në vendngjarje, bëhet e ditur se si shkaktar i aksidentit dyshohet të ketë qenë pakujdesia dhe mospërshtatja e shpejtësisë

me kushtet e rrugës ku për pasojë vetura përfundon jashtë rruge”, u tha në njoftimin e Policisë. Ndërkaq, kryetari i Vushtrrisë, Ferit Idrizi, tha se me veturën e aksidentuar po transportoheshin nxënës nga fshati Duboc i kësaj komune. Ai tha se disa fëmijë të lënduar janë duke marrë mjekësor në emergjencën e spitalit “Sheikh Zayed” në Vushtrri.

Supremja e refuzon ankesën e PDAK-LpB, i hapet rrugë KQZ-së t’i shpallë rezultatet përfundimtare

PRISHTINË, 13 MARS - Gjykata Supreme i ka hapur rrugë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që t’i shpallë rezultatet përfundimtare.

Supremja e ka refuzuar të “pathemeltë” ankesën e PDAK-LpB kundër vendimit të PZAP-it për votimin me postë. Në

arsyetim është thënë se kjo ankesë ishte e pasafatshme. Pasi Supremja ka vendosur për të gjitha 43 ankesat që i ka

pasur nën shqyrtim: 20 janë refuzuar, 11 janë hedhur si të palejuara, 9 janë pranuar dhe 3 janë pranuar pjesërisht.



Inaugurohet sheshi 'Erhard Busek' në Prishtinë

PRISHTINË, 13 MARS - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, së bashku me ambasadorin e Austrisë në Kosovë, inauguruan sheshin 'Erhard Busek' pranë Bibliotekës Kombëtare të Kosovës. "Ky vendim u miratua në unanimitet në Kuvendin Komunal, duke treguar vlerësimin e përbashkët për

figurën dhe kontributin e tij të jashtëzakonshëm. Emërtimi i këtij sheshi është një shenjë mirënjohjeje për angazhimin e palodhur të Erhard Busek në forcimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Austrisë, si dhe për rolin e tij të rëndësishëm diplomatik në rajon", ka shkruar Rama në "Facebook".

Ai ka theksuar se ai ishte një mik i madh i vendit tonë dhe një zë i fuqishëm për stabilitetin dhe bashkëpunimin në Ballkan. "Me këtë shesh ne jo vetëm që nderojmë trashëgiminë e tij, por edhe forcojmë lidhjet mes dy shteteve tona, duke ruajtur kujtimin e një miku të madh të Kosovës", ka thënë Rama.



Një delegacion i pjesëmarrësve të Kursit të Lartë për Siguri dhe Mbrojtje nga Shqipëria viziton Kosovën

PRISHTINË, 13 MARS - Zëvendësministri i Mbrojtjes, Shemsi Syla, ka mirëpritur të enjten pjesëmarrësit e Kursit të Lartë për Siguri dhe Mbrojtje të organizuar nga Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë së Shqipërisë. Ai i uroi mirëseardhje delegacionit, duke e vlerësuar vizitën si një çast i rëndësishëm për forcimin e bashkëpunimit vëllazëror ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. Gjatë takimit zëvendësministri Syla i informoi pjesëmarrësit për përparimin dhe sfidat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, përfshirë zbatimin e planit gjithëpërfshirës të tranzicionit të FSK-së. Ai ndau mendimet e tij mbi situatën e sigurisë në nivel lokal, rajonal dhe global. Në vijim, komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, gjeneralbrigade Ylli Pulaj, shprehu falënderime për mikpritjen dhe vuri në dukje përfshirjen e gjerë në kurs,



duke përfshirë pjesëmarrës nga Shqipëria, Kosova dhe vende të tjera partnere si Gjermania, Rumania, Bullgaria, Turqia, Greqia, Gjeorgjia dhe Italia. Gjeneral Pulaj theksoi qëllimin e këtij kursi si përmirësimi i aftësive dhe cilësive të personelit civil dhe ushtarak përmes shkëmbimit të

përvojave me vendet partnere të NATO-s. Zëvendësministri Syla vlerësoi lart përfshirjen e Kosovës në këtë kurs, duke e konsideruar një dëshmi të bashkëpunimit të ngushtë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë midis Kosovës, Shqipërisë dhe vendeve partnere. Ai përshëndeti fokusin

shkencor dhe strategjik të vizitës, i cili përfshiu trajtimin e aspekteve historike dhe ushtarake të betejave të UÇK-së, me një theks të veçantë në betejën e Koshares, si një moment historik në luftën për liri. Zëvendësministri Syla shprehu angazhimin e vazhdueshëm të Kosovës për zhvillimin e Forcës

së Sigurisë së Kosovës, duke e përgatitur atë si një ushtri moderne dhe e përkushtuar për garantimin e sigurisë rajonale dhe globale. Në kuadër të këtij takimi, shefi i J5J8 të FSK-së, kolonel Haki Hoti, bëri një prezantim të përgjithshëm mbi të arriturat e deritanishme të FSK-së dhe objektivat për të ardhmen.

Pesë vjet nga përhapja e Covid-19: Si e përjetoi Kosova pandeminë?

PRISHTINË, 13 MARS - Kanë kaluar pesë vjet qëkur bota u përball me pandeminë Covid-19, e cila ndryshoi rrënjësisht jetën e miliarda njerëzve dhe sfidoi sistemet shëndetësore në çdo cep të globit. Virusi, i cili u shfaq në fund të vitit 2019 në Wuhan të Kinës, u përhap me shpejtësi, duke shkaktuar një krizë shëndetësore. Në mars të vitit 2020 Organizata Botërore e Shëndetësisë shpalli Covid-19 pandemi, duke detyruar shumicën e vendeve të vendosnin masa të rrepta kufizuese. Kosova konfirmoi rastin e parë me Covid-19 më 13 mars 2020 dhe menjëherë autoritetet vendosën masa të ashpra për

ta frenuar përhapjen e virusit. Kufizimet në lëvizje, mbyllja e shkollave, ndalimi i grumbullimeve dhe ndërprerja e aktiviteteve ekonomike krijuan një situatë të panjohur për qytetarët. Sistemi shëndetësor, i cili tashmë përballej me sfida të shumta, u gjend nën një presion të madh për t'i trajtuar pacientët e infektuar dhe për t'i siguruar pajisjet mjekësore të nevojshme. Gjatë pandemisë Kosova ka regjistruar mbi 270 mijë raste të konfirmuara me Covid-19 dhe më shumë se 3 200 viktima. Numri real i të infektuarve dhe viktimave mund të jetë edhe më i lartë,



duke marrë parasysh rastet e paidentifikuara. Një nga sfidat më të mëdha gjatë pandemisë ishte procesi i vaksinimit.

Kosova filloi fushatën e vaksinimit në mars të vitit 2021, fillimisht me furnizime të kufizuara, duke u mbështetur në donacione dhe

mekanizmat ndërkombëtarë si COVAX. Deri në vitin 2023 vetëm rreth 60 % e popullsisë kishte marrë të paktën një dozë të vaksinës. Sot, pesë vjet pas fillimit të pandemisë, Covid-19 nuk është më një kërcënim, por pasojat e tij vazhdojnë të ndihen në shëndetin publik, ekonominë dhe jetën e përditshme. Pandemia Covid-19 mbetet një mësim i rëndësishëm për institucionet dhe shoqërinë në përgjithësi, duke treguar nevojën për investime më të mëdha në shëndetësi dhe për një përgatitje më të mirë për emergjencat të ngjashme në të ardhmen. (ksp)

Rikonfirmohet bashkëpunimi ndërmjet forcave të armatosura të Kosovës dhe Shqipërisë

PRISHTINË, 13 MARS - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (KOMFSK), gjeneralëjtënant Bashkim Jashari, ka pritur të enjten në takim komandantin e Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë të FARSh, gjeneralbrigade Ylli Pulaj.

Gjeneral Jashari fillimisht i uroi mirëseardhje gjeneralit Pulaj dhe e falënderoi për mbështetjen e vazhdueshme që Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSh) janë duke dhënë për Forcën e Sigurisë së Kosovës

(FSK). Ndërsa gjeneral Pulaj falënderoi gjeneral Jasharin për pritjen e ngrohtë dhe për bashkëpunimin e vazhdueshëm që personeli i FARSh-it dhe ai i FSK-së kanë realizuar së bashku në trajnime

dhe shkollime të ndryshme. Në fund të dy gjeneralët rikonfirmuan bashkëpunimin ndërmjet forcave të armatosura të të dyja vendeve dhe u pajtuan për ngritjen e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen.



ZKA-ja mori pjesë në takimin e parë të përbashkët për qëllimet strategjike të EUROSAI 2024-2030

PRISHTINË, 13 MARS - Më 5-6 mars 2025 në Bratislavë të Sllovakisë u mbajt takimi i parë i përbashkët i EUROSAI-t për Qëllimet Strategjike 1 dhe 2 me temën “Galeria: pamje strategjike 2024-2030”. Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) në këtë takim u përfaqësua nga drejtoresha e Departamentit për Komunikim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, Qendresa Mulaj. Ky aktivitet bashkoi përfaqësues nga institucionet

supreme të auditimit nga vende të ndryshme të Evropës për të diskutuar për prioritetet strategjike dhe projektet e ardhshme në kuadër të objektivave strategjike të EUROSAI-t. Punimet e takimit filluan me fjalët hyrëse të presidentit të Zyrës Supreme të Auditimit të Sllovakisë, Lubomir Andrassy dhe presidentit të EUROSAI-t, Matanyahu Engلمان, të ndjekura nga prezantimet mbi vizionin strategjik të organizatës dhe qëllimet

kryesore për vitet e ardhshme. Përgjatë dy ditëve pjesëmarrësit ndoqën prezantime mbi projekte konkrete si dhe diskutime mbi zhvillimet e ardhshme. Në kuadër të Galerisë Strategjike u paraqit puna dhe arritjet e grupeve punuese dhe task forcave të EUROSAI-t si dhe u mbajtën sesione interaktive për shkëmbimin e ideve, perspektivat e reja dhe mundësitë për bashkëpunim të mëtejshëm ndërmjet



anëtarëve të EUROSAI-t. Ky takim shënoi një hap të rëndësishëm për forcimin e bashkëpunimit në mes të

institucioneve supreme të auditimit dhe orientimit strategjik të EUROSAI-t për vitet në vijim.

Çmimet në “qiell”, qytetarët ankohen për shtrenjtimin e perimeve

PRISHTINË, 13 MARS - Ngritja e çmimeve të produkteve ushqimore në Kosovë, përkatësisht atyre të perimeve, është ajo çka po i shqetëson qytetarët e vendit. Perimet gjatë këtyre ditëve kanë arritur çmime rekorde në Kosovë. Aktualisht çmimi për një kilogram spec arrin rreth 5 euro. Këto çmime, sipas qytetarëve të Kosovës, janë të larta prandaj, sipas tyre, duhet të ndërhyjnë institucionet shtetërore sa më parë ndaj tregtarëve për rregullimin e çmimeve. Ndërsa nga Shoqata “Konsumatori”, kjo rritje është quajtur inflacion global.

Qytetari Azem Hasani ka thënë për “KosovaPress” se këto çmime u dyfishuan në kohën e muajit Ramazan. Me dy qese në duar Hasani u shpreh se duhet të marrë pak gjëra në treg pasi, sipas tij, me 100 euro pension nuk po ia arrin të furnizohet mjaftueshëm me produkte ushqimore. Ndërsa Rrahim Plakiqi është shprehur se ata që nuk kanë përkrahje nga bashkatdhetarët janë në gjendje të rëndë ekonomike për shkak të çmimeve të ngritura. Sipas Plakiqit, as protestat nuk mund t'i ulin këto çmime. Ai kërkon nga shteti t'i mbështesë

qytetarët në mënyrë që t'ua lehtësojë qytetarëve përballimin e çmimeve të larta në treg dhe nëpër dyqane. E Vesel Veseli ka kërkuar nga organet kompetente t'i vizitojnë marketet dhe tregjet për, siç theksoi ai, “për t'i ndëshkuar tregtarët që vendosin çmime të paarsyeshme”. Kryetari i Shoqatës “Konsumatori”, Selatin Kaçaniku, e quan inflacion global, duke thënë se arsyeja kryesore e inflacionit është se Kosova nuk ka monedhën e saj. Gjatë këtyre ditëve rritja e çmimeve u vërejt edhe te produktet e tjera të perimeve.



“15 mars, Kosova bojkoton të gjitha supermarketet”



PRISHTINË, 13 MARS - Iniciativa “Kosova bojkoton” ka bërë thirrje për bojkotimin e të gjitha supermarketeve në Kosovë më 15 mars për shkak të ngritjes së çmimeve. Aktivistët e iniciativës kanë shpalosur të enjten një pankartë me mbishkrimin “15 mars, Kosova bojkoton të gjitha supermarketet”. Xhevat Kastrati, anëtar i kësaj initiative, u ka bërë thirrje qytetarëve t'i bashkohen kësaj initiative për bojkotimin e

marketeve. Ai ka thënë se përmes bojkotit tregojnë fuqinë e tyre blerëse dhe se dërgojnë një mesazh te marketet dhe qeveria për pakënaqësinë e tyre për rritjen e çmimeve. “Ne jemi grupi ‘Kosova bojkoton’. Jemi grup joformal qytetar që kemi marrë si nismë punën e rritjes së çmimeve. Kjo është një lloj proteste përmes bojkotit që jemi duke e realizuar. Thirrja për qytetarët është që t'i bashkohen nismës tonë dhe ta

ngrehim zërin përmes një bojkoti, duke treguar fuqinë tonë blerëse. Kur të gjithë bashkohemi në bojkot, dërgojmë një mesazh te marketet dhe qeveria se jemi shumë të pakënaqur dhe e bëjmë një lloj presioni shoqëror për të sjellë një reagim”, ka thënë Kastrati. Këso lloj nismash për bojkotimin e marketeve janë duke u zhvilluar edhe në vendet e rajonit për shkak të rritjes së çmimeve.

Tregu i përbashkët, Rafuna: Synohet nxitja e zhvillimit ekonomik në rajon

PRISHTINË, 13 MARS - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës dhe Forumit Investiv të 6 Odave të Ballkanit Perëndimor, Lulzim Rafuna, ka zhvilluar një takim me sekretarin e përgjithshëm të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC), Amer Kapetanovic, për të diskutuar për bashkëpunimin mbi agjendat rajonale të përbashkëta brenda Planit të Veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal (CRM), i cili synon ta nxisë zhvillimin

ekonomik në rajon. Në njoftimin për medie thuhet se gjatë takimit të dyja palët theksuan rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit ndërmjet “WB6 CIF” dhe “RCC” për ta avancuar integrimin rajonal, lehtësuar tregtinë dhe zgjeruar mundësitë e bizneseve të Ballkanit Perëndimor në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare. “Gjithashtu, u diskutuan iniciativa për përmirësimin e klimës së investimeve dhe mbështetjen e ndërmarrjeve të

vogla dhe të mesme”, thuhet në njoftim. Po ashtu, thuhet se duke pasur parasysh rolin që “WB6 CIF” dhe “RCC” luajnë në avancimin e agjendave rajonale në fushat e tyre përkatëse, Rafuna dhe Kapetanovic u pajtuan ta vazhdojnë bashkëpunimin në rezultate konkrete brenda CRM, të cilat do të kenë një ndikim pozitiv në rritjen ekonomike dhe integrimin e rajonit në Tregun e Përbashkët të BE-së.



DEMONSTRATAT E VITIT 1981 NË KOSOVË, SIPAS REVISTËS GJERMANE “DER SPIEGEL”

PERSEKUTIMI I SHQIPTARËVE

Shkruan: Mr. sc. Naim
J. KRASNIQI

Ngjarjet, demonstratat, rebelimi, dhe shpeshherë quhej edhe kryengritje e shqiptarëve që jetonin në Jugosllavi, kanë ndodhur gjatë pranverës së vitit 1981. Ka shumë shkrime dhe interpretime në lidhje me këtë periudhë, por edhe sot e kësaj dite nuk është plotësisht e qartë se si shpërtheu ky rebelim i fuqishëm, që tronditi dhe u bë gangrenë deri në shkatërrimin e Jugosllavisë. Dihet se shqiptarët që jetonin në territorin e Jugosllavisë kurrë nuk e ndjenë atë si shtetin e tyre, por ishin të detyruar ta pranonin si të tillë dhe të jetonin, punonin dhe kryenin shërbime ndaj këtij shteti. Historia e vështirë e bashkëjetesës me sllavët, e veçanërisht me serbët, bëri që shqiptarët gjithmonë të mësoheshin dhe të edukoheshin se ky shtet ishte i huaj për ta. Prandaj, me çdo kusht, ata besonin se duhet të vepronin për t'u ndarë dhe për t'u bashkuar me shtetin amë. Kjo ndodhte përmes ngjarjeve historike që kishin ndodhur më herët. Patriotët shqiptarë e kishin të qartë se kjo pozitë ishte paracaktuar nga qarqe diplomatike, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore. Ata e dinin se ky ishte një proces i gjatë, por duhet vepruar.

Shteti komunist jugosllav ndërmerre masa represive kundër shqiptarëve, duke filluar nga rrahjet, poshtërimet, burgosjet dhe eliminimin e tyre. Për pozitën e shqiptarëve në Jugosllavinë komuniste, besoj se më së miri e ka përshkruar poeti shqiptar Esad Mekuli në poezinë e tij “Njeriu me Bishte”, pas Plenumit të Brionëve (1966), ku pushteti i Titos, i shqetësuar për rrezikun nga nacionalizmi dhe shovinizmi serb, premtoi se do të përmirësohej pozita e shqiptarëve sipas parullës “Vëllazërim-Bashkim”. Ai gjithashtu premtoi se do të dënoheshin të gjithë ata që kishin ushtruar dhunë kundër shqiptarëve. Megjithatë, ndonëse kjo politikë vazhdoi pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 1974, kur pozita juridike e Kosovës u avancua, disa konstatuan se Kushtetuta e asaj kohe nuk e barazonte Kosovën me njësitë e tjera federative që kishin statutin e Republikës, siç e interpretonin disa: “...se vetëm emri nuk ishte Republikë.” Siç thashë, shqiptarët persekutoheshin, maltretoheshin dhe burgoseshin për qëndrimet e tyre politike. Një personalitet i tillë dhe një dëshmi e gjallë e jetës së shqiptarëve në Jugosllavi ishte Adem Demaçi, i cili kaloi rininë dhe pjesën më të madhe të jetës së tij në kazamatet jugosllave, me 28 vite të kaluara pas grilave. Kjo është një dëshmi e rëndësishme e jetës së shqiptarëve në Jugosllavi. Përveç Demaçit, ka shumë veprimtarë të tjerë që kontribuan në edukimin e rinisë shqiptare për t'u kundërvënë kësaj shtate. Duhet

përmendur gjithashtu veprimtaritë e shumë organizatave politike që propagandonin për ndryshim dhe që ndihmonin në mobilizimin e masave. Situata shoqërore, politike dhe ekonomike që po përjetonte Jugosllavia, e veçanërisht pas vdekjes së Titos në vitin 1980, krijoi kushte që çuan në protesta. Sipas një artikulli të revistës gjermane “Der Spiegel”, në fund të vitit 1980 kishte pasur një pakënaqësi mes studentëve, por pas bisedave me strukturat politike të Kosovës, kjo pakënaqësi u zbut dhe nuk u bë e njohur për opinionin. Ka pasur arrestime, por ato nuk u reflektuan aq shumë në opinion, pasi arrestimet ishin të përditshme. Një element tjetër është se organizatat politike me pikëpamje marksiste-leniniste, gjatë shpërthimit të rebelimit të 11 marsit në Mensën e Studentëve, deklaruan se nuk kishin pasur njohuri për këtë ngjarje dhe se u gjetën në një situatë të papritur. Pas demonstratave të 26 marsit, ata pranuan se kishin qenë në krye të organizimit të këtyre protestave. Prandaj, rebelimi i studentëve më 11 mars ishte një shkëndijë për një demonstrim masiv dhe të fuqishëm. Analistët e “Der Spiegel” theksuan se “rebelimi dhe demonstrimi nuk ishte një mbështetje për studentët, që siç thuhet, si supa që gatuan...” Në këtë shkrim do të trajtojmë katër artikuj të revistës “Der Spiegel” të vitit 1981, që janë botuar gjatë atij viti, pasi kjo revistë ka shumë shkrime, analiza, hulumtime dhe komente edhe më herët, por edhe deri në ditët e sotme, që

JUGOSLAWIEN

Ohne roten Stern

Gefahr für den Vielvölkerstaat: Die albanische Minderheit im Süden rebelliert. Ihr Siedlungsgebiet war von Militär abgeriegelt.

mund të jenë të rëndësishme për opinionin tonë. Shkrimi i parë, në formë njoftimi dhe komenti për atë që kishte ndodhur në Kosovë gjatë muajve mars dhe prill, u botua më 12 prill (në rubrikën e jashtme), me një titull mjaft domethënës duke përmendur shtetin jugosllav dhe titullin “Ohne roten Stern” (Pa Yllin e Kuq). Ky titull tërhoqi vëmendjen e lexuesve, pasi Jugosllavia ishte e njohur si shtet socialist dhe komunist, dhe titulli ngjallte pyetje se çfarë po ndodhte që nuk shihej Ylli, simbol i komunizmit. Në nëntitull, autori paralajmëronte për rrezikun që mund të vinte nga pakënaqësitë e kombeve të tjera që jetonin në këtë shtet federal. Siç e theksova më lart, shkrimi i parë në “Der Spiegel” ishte botuar në edicionin e datës 12 prill të vitit 1981 (Nr. 16), për atë që kishte ndodhur në Kosovë.

JUGOSLLAVIA PA YLLIN E KUQ

“Rreziku për shtetin multietnik: Minoriteti shqiptar në jug të vendit po rebelohet. Rajoni i tyre (shqiptarët) është bllokua nga ushtria.” Pra, që në fillim të analizës, autori paralajmëron

për pasojat e këtyre demonstratave për Jugosllavinë. “Ajo që po ndodhte në jugun e thellë të vendit, jugosllavët mund ta mësonin vetëm nga aludime (sugjerime apo fjalë që dëgjoreshin në korridore të ndryshme apo grupe të ndryshme komentatorësh. – N.K.). Fillimisht, shtypi i partisë (gazeta e vetme e përditshme në gjuhën shqipe “Rilindja”, po ashtu edhe gazeta “Jedinstvo” e përditshme në gjuhën serbe) heshti, më pas raportoi për “fenomene” të dëmshme dhe “armiqësore”, dhe përfundimisht, territori u bllokua jo vetëm për gazetarët e huaj, por edhe për ata vendas.” Përkundër këtij terri informativ, doli një zë dezinformues, ku kishte vetëm një të vërtetë: “...përmes një deklarate, zëdhënësi i partisë Stane Dolanc, ish-sekretar i Titos, bëri të ditur se gjatë trazirave në rajonin e Kosovës kishin humbur jetën njëmbëdhjetë njerëz. Në Kosovë, në ‘Amselfeld-in’, (Fushë – N.K.) historike të Kosovës, jeton minoriteti shqiptar në Jugosllavi.” Ndërsa, ky analist jep edhe një arsye, si të themi, se: “Më 9 mars, policia sekrete e Jugosllavisë arrestoi profesorin shqiptar të historisë, Ahmet Malokun, dhe dy ditë më pas, studentët e Universitetit të Provincës në Prishtinë shpërthyen në protesta.” Dhe duke përshkruar rrjedhën dhe kërkesat e kësaj proteste: “Ata kërkonin ushqim më të mirë në mensën e tyre, pas një tentative ndërmjetësimi nga rektori i Universitetit,” studentët “kërkuan gjithashtu më shumë liri politike.” Rektori, duke dëgjuar këto kërkesa politike, analisti konstaton se: “Rektori i dha dritën jeshile për një sulm të forcave të policisë ndaj konvikteve studentore, duke çuar në arrestimin e 50 studentëve.” (Se ku i ka marrë këto të dhëna analisti nuk jep burimin.) Si pasojë e këtyre masave, studentët u revoltuan edhe më tepër, përkundër aktiviteteve politike që zhvillonin strukturat politike (komuniste të Kosovës dhe të rinisë) me studentët. Thua se e gjithë java u karakterizua me këto takime, por nuk patën sukses, sepse studentët kërkonin lirinë e të



arrestuarve, për çka komunistët kosovarë nuk ishin të gatshëm. Prandaj, “Më 26 mars, dhjetëra mijëra studentë, nxënës, punëtorë grevistë dhe qytetarë dolën në rrugë duke kërkuar pavarësinë e popullit shqiptar.” Në atë kohë, manifestohej “udhëtimi i stafetes së Titos”, që simbolizonte vazhdimësinë e rrugës së Titos, sipas komunisteve jugosllavë. Ky simbol komunist ishte parashikuar që të vinte në Prishtinë më 26 mars të vitit 1981. Sigurimi i shtetit kishte ndërmarrë të gjitha masat për sigurimin e pritjes dhe përcjelljes së saj, e në anën tjetër arsyetonin edhe arrestimet që kishin ndodhur dhe ndodhnin gjatë kësaj periudhe, por më duket se edhe studentët e kishin shprehur kundërshtimin e tyre kundër këtyre arrestimeve si dhe këtij manifestimi. Pjesëmarrja ishte masive, sepse studentëve iu bashkuan edhe qytetarë të tjerë të strukturave të ndryshme shoqërore, e sidomos pasi kishin shikuar dhunën e shfrenuar të organeve të sigurimit si dhe aksionet e policisë kundër studentëve. Analiza nuk përshkruan rrjedhën e ngjarjeve, por analizon gjendjen.

“Për herë të parë pas Luftës së Dytë Botërore, një rajon i tërë u izolua nga bota e jashtme, dhe forca ushtarake u dërgua me helikopterë dhe kamionë nga pjesë të tjera të vendit (kuptohet nga republikat e tjera të Jugosllavisë – N.K.), e që vetëm se shtoi zemërimin e popullsisë shqiptare.” Pas aplikimit të Gjendjes së Jashtëzakonshme në Kosovë, në opinionin jugosllav u kuptua se diçka serioze po ndodhte. Është interesante se më 30 mars 1981, në Zagreb ishte organizuar një protestë nga studentët shqiptarë që studionin në universitetet e Kroacisë në shenjë solidariteti me studentët e Prishtinës, por kësaj proteste iu kishin bashkuar edhe shumë kroatë. “Rebelimi në Prishtinë u shtri në të gjithë provincën, madje përtej kufijve të saj në Zagreb, studentët shqiptarë (që studionin në universitetet e Kroacisë – N.K.) me përkrahjen e shokëve të tyre kroatë, ngritën flamujt pa yllin e kuq të komunizmit.” Qeveria shpejt kërkoi të “lokalizonte” këtë pakënaqësi, për të mos infektuar edhe popujt e tjerë të pakënaqur të Jugosllavisë. Valvitja e flamujve shqiptarë dhe kroatë pa yll, si dhe kërkesa për mos përdorimin e dhunës kundër demonstruesve në Prishtinë, kundër ndjekjes së shqiptarëve sepse ata kishin të drejtë në kërkesat e tyre, si dhe kërkesa për lirimin e të gjithë të burgosurve politikë, analizës i jep një kuptim tjetër. Se, regjimi jugosllav përndiqte qytetarët e saj për shprehjen e mendimit të lirë. Prandaj kërkesat e shqiptarëve duhej të ndaloheshin dhe shteti kishte ndërmarrë masa.

“Pamja e rrugëve në Kosovë javën e kaluar shihej kështu:

Helikopterë duke fluturuar mbi dhe rreth kryeqytetit të Kosovës – në Prishtinë, nëpër rrugë kamionë dhe autobusa ushtarakë të djegur dhe të rrëzuar, copa xhamash dhe gazhoja të plumbave.” Në këtë analizë kemi edhe deklarin e një “gastarbeiter” (emigranti shqiptar që punonte në Gjermani), punëtori shqiptar që kishte deklaruar: “Një punëtor shqiptar, që po kthehej në Gjermani nga një vizitë në atdhe, betohej përpara Kuranit se ‘kishin humbur jetën 235 persona dhe ishin plagosur 2553 të tjerë.’ Ai pohonte se kishte parë me sytë e tij se si milicët serbë që ishin dërguar në Kosovë hapën zjarr mbi fëmijë në një urë pranë tregut të vjetër të Mitrovicës, gjë që e kishte shtyrë një milic shqiptar të hapte zjarr ndaj kolegëve të tij serbë. Po ashtu, thuhet se 25 oficerë shqiptarë të policisë kishin refuzuar të hapnin zjarr ndaj bashkëkombësve të tyre.” (Pra kjo është një deklaratë e një punëtori shqiptar që punonte dhe jetonte në Gjermani, por se sa është e saktë kjo, mbetet për t’u hulumtuar. Sipas të gjitha burimeve dhe bisedave me organizatorë dhe pjesëmarrës të këtyre demonstratave, numri nuk është më i madh se 11 të vrarë, edhe pse ka pasur deklarime të ndryshme duke u munduar që të zvogëlohej nga politikanët shqiptarë diku filluar nga 7, 8 dhe 9, por deri më sot nuk kemi asnjë të dhënë tjetër, sepse këtë e dinin edhe familjarët e të rënëve – vrarëve. – N.K.)

Më poshtë, analiza jep edhe një historik se si kishte mbetur Kosova dhe shqiptarët nën Serbi: “Me milicët serbë dhe Ushtrinë Popullore të Jugosllavisë, Beogradi ndërhyri në Fushë të Kosovës. Urrejtja mes serbëve dhe shqiptarëve ka një histori të gjatë: Në vitin 1913, kur Perandoria Osmane ra, malazezët, grekët dhe serbët ndanë territorin e iliro-shqiptarëve, të cilët nuk (ngjashmëri) dhe as janë të lidhur me asnjë komb tjetër të Evropës. Një pjesë e vogël e shqiptarëve arriti të jetojë në një shtet të vetin – për një kohë të shkurtër nën princin gjerman të Wied. Pjesa më e madhe (territoreve të shqiptarëve – N.K.) kaloi nën Serbi, dhe pse atje as nuk mund të flisnin gjuhën e tyre amtare.” Ky konstatim i autorit të analizës është një konstatim i gabuar kur thotë se shqiptarët erdhën në Serbi, unë mendoj se ka qenë i ndikuar nga propaganda serbe. Tito – një udhëheqës i luftës partizane në Jugosllavi rekrutoi shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore, të cilët vetë e quanin “Skipetar” (Shqiptarët e Malit – shpjegim i autorit të analizës). Por edhe në Jugosllavinë komuniste, ata nuk morën një republikë të vetën.” Duke vazhduar me përshkrimin e qëndrimeve jo të drejta të Jugosllavisë së Titos ndaj shqiptarëve.

Në vitin 1966, Beogradi zbuloi se cilat ishin krimet që ishin bërë ndaj shqiptarëve: Policia sekrete



keinem anderen Volk Europas verwandt sind.

Foto: “Asnjë popull tjetër në Evropë nuk është kaq i afërt.”

jugosllave, nën drejtimin e Ranković-it, një serb ekstremist, kishte vrarë mijëra shqiptarë. Shtypi i partisë në atë kohë shkruante: “As sulltanët turq, as mbretërit serbë dhe malazezë nuk kishin bërë asgjë më të tmerrshme se sa ky regjim.” Megjithatë, gjendja nuk u përmirësua shumë: Edhe pse Tito u premtoi shqiptarëve se do të zhvilloheshin (në sferën ekonomike – N.K.) më shpejt se popujt e tjerë të Jugosllavisë, por përkundrazi territori i Kosovës ra në një varfëri të thellë. Nga viti 1967 deri në vitin 1976, produkti social për frymë i shqiptarëve në Jugosllavi ra me 24 për qind – krahasuar me të ardhurat mesatare të trevave të tjera jugosllave.”

“Shqiponjat e malit megjithatë u rritën në mënyrë kërcënuese (për mentalitetin e të menduarit jugosllav – N.K.) – nga një milion (1961) në 1.6 milion banorë sot. Ata së shpejti do të jenë populli i tretë më i madh në Republikën Federative të Jugosllavisë – por ata ende nuk (kanë statutin e Republikës – N.K.) janë shteti i kësaj federate, por thjesht janë një ‘rajon autonom’ i shtetit federal të Serbisë.” Këtu autori sqaron pozitën e Kosovës në kuadrin e njësisë federale të Serbisë. Beogradi frikësohet se një republikë shqiptare pranë atyre të gjashtë republikave të tjera të Jugosllavisë do të kërkonte menjëherë shkëputjen

dhe bashkimin me Shqipërinë. Është një pjesë e analizës dhe komenteve mbi ngjarjet që ndodhën gjatë demonstratave të studentëve dhe protestave të tjera në Kosovë në vitin 1981, duke theksuar situatën politike, shoqërore dhe mediatike që kishte shpërthyer pas këtyre ngjarjeve.

Në fillim, analisti përshkruan situatën e tensionuar dhe thekson rrezikun që mund të shfaqet nacionalizmi i tjerë në Jugosllavi si përgjigje ndaj nacionalizmit shqiptar, duke përmendur si paralel të ngjarjeve një tendencë që kishte ndodhur më herët në Jugosllavi, kur disa grupe, si slovenët, kishin shprehur dëshira për autonomi ose ndarjen nga federata. Ky është një argument i rëndësishëm që i jep autoritetit të Beogradit arsytim për masat që mori për të shtypur protestat shqiptare dhe për të mbrojtur “unitetin” e shtetit jugosllav.

Në këtë analizë, ndodhen gjithashtu disa deklarata që akuzojnë vendet e huaja për përfshirje në ngjarjet që ndodhën në Kosovë. I referohet një “qendër sekrete” që ndodhej në Gjermani, ku emigrantë shqiptarë, si Emil Kastrioti, organizonin dhe mbështetnin protestat në Kosovë. Kjo është një akuzë që është përdorur si një justifikim për masat represive ndaj shqiptarëve dhe emigrantëve që jetonin jashtë

Jugosllavisë.

Ndërkohë, analisti thekson se situata në Kosovë ishte e pakontrolluar dhe se autoritetet jugosllave filluan një ndjekje të gjerë kundër shqiptarëve, duke përdorur metoda të dhunshme, duke përfshirë arrestime dhe shtrëngime ndaj aktivistëve të rinj. Shtypi jugosllav përhapte një narrativë të caktuar, duke akuzuar Shqipërinë, NATO-n dhe agjenturat e huaja për përfshirje në ngjarjet që ndodhën. Kjo propagandë shërbente për të krijuar një imazh të rrezikut të madh që kërcënonte shtetin jugosllav, duke e prezantuar rebelimin shqiptar si një kërcënim të drejtpërdrejtë për ndarjen e Kosovës nga Jugosllavia.

Në fund, analisti përshkruan masat e vendosura për të pastruar strukturat udhëheqëse shqiptare dhe për të rehabilituar disa figura që ishin të përshtatshme për regjimin, duke synuar të ruanin stabilitetin politik në Serbi dhe në pjesë të tjera të Jugosllavisë. Ky fragment pasqyron kompleksitetin e situatës politike dhe shoqërore në Jugosllavi gjatë periudhës së demonstratave, duke nxjerrë në pah tensionet midis grupeve etnike, shtypjen e pakënaqësisë dhe manovrat politike të udhëheqësve jugosllavë për të ruajtur kontrollin mbi territoret dhe popujt që kishin qenë pjesë e federatës. (Vijon)

NË RENDIN E RI BOTËROR TË DONALD TRUMPIT

Ideja e Amerikës si një komb i jashtëzakonshëm shpesh ofrohet përmes shprehjes “një qytet i ndriçuar mbi kodër”. Por njerëzit harrojnë se si John Winthrop e përdori për herë të parë këtë përshkrim në vitin 1630, teksa i drejtohej grupit të tij të Pelerinëve që po niseshin drejt Botës së Re: “Ne do të jemi si një qytet mbi një kodër, sytë e të gjithë njerëzve janë mbi ne.”

Sot, sytë e botës me siguri janë mbi Amerikën, por shumë vëzhgues të huaj përshkruajnë një qytet dikur të ndriçuar, i cili duket se po zhytet në errësirë. Ata shohin se si Presidenti Donald Trump po transformon politikën e jashtme të Amerikës dhe imazhin e saj në botë. Në vend të një ndërkombëtarizmi të butë, por të admiruar globalisht, Trump promovon vlerat e ngushta dhe transaksionale të një biznesmeni të pasurive të paluajtshme. Ai sillet sikur bujaria është për budallenjtë. Në botën e tij, kombet e fuqishme domosdoshmërisht dominojnë të dobëtit dhe fuqia përcakton çfarë është e drejtë. Pyetja që ngrihet është: Teksa Trump po shkatërron versionin e vjetër të politikës së jashtme amerikane, çfarë synon të ndërtojë në vend të saj? Karriera e tij na jep pak dëshmi për një mendim strategjik. Ai ka qenë më shumë një përçarës dhe negociator sesa ndërtues. Mandati i tij i parë u shenjua nga ndryshime të vazhdueshme në personel dhe politika, me pak arritje të qëndrueshme.

Vlerësimi më i mirë për “vizionin” strategjik të Trump-it që kam parë vjen nga Alex Younger, ish-drejtues i shërbimit inteligjent britanik MI6. Në një intervistë më 21 shkurt për BBC “Newsnight”, ai tha se “ne jemi në një epokë të re ku, përgjithësisht, marrëdhëniet ndërkombëtare nuk do të përcaktohen nga rregullat dhe institucionet shumëpalëshe. Atë do të përcaktohen nga njerëzit e fuqishëm dhe marrëveshjet.” Younger krahasoi diplomacinë e ashpër të Trump-it me Konferencën e Jaltës të vitit 1945, ku liderët dominues të kohës së luftës – Presidenti Franklin D. Roosevelt, udhëheqësi sovjetik Joseph Stalin dhe Kryeministri britanik Winston Churchill – ndanë Evropën pa marrë parasysh dëshirat e kombeve më të vogla. “Ky është botëkuptimi drejt të cilit po shkojmë për një sërë arsyes, dhe nuk besoj se do të kthehemi pas te ai që kishim më parë,” argumentoi Younger. Shembulli më i qartë i këtij



mentaliteti neo-Jaltë është mënyra se si Trump ka zhvilluar fazën paraprake të negociatave për paqen në Ukrainë. Ai ka ushtruar presion mbi presidentin e dobët ukrainas, Volodymyr Zelensky (“Ti nuk i ke letrat në dorë”) që të përshtatet me ato që ai i sheh si interesat e lojtarëve të mëdhenj: Shtetet e Bashkuara dhe Rusia. Duke ndjekur këtë marrëveshje paqeje, ai shpall se “edhe Kina mund të ndihmojë”.

Trumpi duket se parashikon një ekuilibër të ri të fuqive me tre shtylla kryesore: Shtetet e Bashkuara, plus Rusinë dhe Kinën, udhëheqësit e të cilave ai i sheh si të ngjashëm. Pjesa tjetër e botës, përfshirë aleatët më të vjetër të Amerikës, duhet të kujdeset vetë për veten. Reagimi i zemëruar i senatorit francez Claude Malhuret në një fjalim javën e kaluar është cituar në mbarë botën: “Mesazhi i Trump-it është se të qenit aleat i tij nuk ka asnjë dobi, sepse ai nuk të mbron, të vendos më shumë tarifa se sa armiqve të tij dhe të kërcënon të të marrë territoret e tua, ndërsa mbështet diktatorët që të pushtojnë.”

Bota nuk ka të drejtë vote për politikën amerikane, por ka mendime të forta. Një sondazh evropian i publikuar këtë muaj tregoi se perceptimi pozitiv për

Shtetet e Bashkuara ka rënë ndjeshëm në Britani, Danimarkë, Francë, Gjermani, Itali, Spanjë dhe Suedi – duke u ulur me 20 pikë ose më shumë në disa nga këto vende. Në Kanada, vetëm 1 në 3 persona ka një opinion pozitiv për Amerikën e Trump-it. Një sondazh i dhjetorit zbuloi se 63 për qind e japonezëve janë të shqetësuar për një mandat të dytë të Trump-it.

Ajo që e ka habitur botën është se sa shpejt Trump ka përmbysur angazhimet e kahershme të Shteteve të Bashkuara. Sekretari i Shtetit, Marco Rubio, u mburr të hënën se kishte shkurtuar 83 për qind të programeve të USAID.

Trump e ndaloi ndihmën ushtarake dhe të inteligjencës për Ukrainën për të ushtruar presion për lëshime. Ai e çmontoi kundërvënien e SHBA-së ndaj Rusisë së Vladimir Putinit aq shpejt, sa një zëdhënës i Kremlinit deklaroi: “Administrata e re po ndryshon me shpejtësi të gjitha konfigurimet e politikës së jashtme. Kjo përputhet gjerësisht me vizionin tonë.”

Trumpi mund të jetë duke bërë një gabim të madh me përçmimin e tij për Evropën – e cila duket se po gjen zërin e vet pas dekadash ndjekjeje pasive të Uashingtonit.

Liderë evropianë thonë se janë aq të shqetësuar për një Rusi ekspansioniste, sa që janë të gatshëm të ndërmarrin një qëndrim të fortë në Ukrainë duke angazhuar trupa për të penguar agresionin e mëtejshëm pas një armëpushimi. Rusët janë të zemëruar, por nëse Evropa qëndron e palëkundur, a do të mbajë vërtet Trumpi anën e Putinit kundër aleatëve më të afërt të Amerikës? E dyshoj.

Strategjia ekonomike globale e Trump-it është më e qartë sesa objektivat e tij të politikës së jashtme, por jo më pak destabilizuese. Ai propozon rikthimin e barrierave tarifore të vendosura në fund të shekullit të 19-të, kur Shtetet e Bashkuara po përpiqeshin të zhvillonin industrinë e tyre prodhuese përballë konkurrencës evropiane. Në teori, ngritja e mureve të ngjashme tarifore do të rriste aq shumë çmimet e importeve, sa që investitorët do të nxiteshin të ndërtonin fabrika të reja dhe të nisin “Epokën e Artë të Amerikës” së Trump-it.

Por ky proces – “periudha e tranzicionit”, siç e quajti Trump këtë javë – ka të ngjarë të zgjasë shumë vite. Në të vërtetë, kjo strategji e bazuar tek tarifatat nuk përputhej as me ekonominë globalizuese të Epokës së Artë,

e lëre më me Amerikën e shekullit XXI. Edhe vetë presidenti William McKinley, kampioni i tarifave të larta, e kuptoi më vonë se “barrierat e tepruara tregtare do të pengonin zhvillimin dhe do të kufizonin potencialin e rritjes së vendit,” siç shkruan biografi i tij, Robert W. Merry. Deri në fund të presidencës së tij në vitin 1901, McKinley “e pa qartë një epokë të re ku Amerika do të luante një rol të madh në tregtinë globale.”

Shumë ekonomistë e shohin vizionin e Trump-it si të paqëndrueshëm. Por le të imagjinojmë se muret tarifore të Trump-it arrijnë të tërheqin Shtetet e Bashkuara jashtë sistemit ekzistues ndërkombëtar të tregtisë. Si do të reagoje pjesa tjetër e botës? Fillimisht, vendet e tjera do të vendosnin tarifatat e tyre, ashtu siç kanë filluar ta bëjnë tashmë Kanadaja, Meksika dhe Kina. Por me kalimin e kohës, këto vende ka të ngjarë të formojnë koalicione tregtare – me Evropën dhe Jugun Global që do të arrinin marrëveshje me Kinën, gjithnjë e më dominuese, duke shmangur “Kështjellën Amerikë”.

Lawrence H. Summers, profesor në Harvard dhe një nga ekonomistët më ndikim në botë, argumentoi këtë javë se strategjia ekonomike e Trumpit, e bazuar tek tarifatat, është “tërësisht kundërproduktive.” Duke vënë në dukje rënien e mprehtë të tregjeve financiare, ai shkroi në X: “Po përjetojmë më të keqen e të dyja botëve – shqetësime për inflacionin dhe një ngadalësim ekonomik, si dhe më shumë pasiguri për të ardhmen, dhe kjo ngadalëson gjithçka.”

Këtu qëndron ajo që Trump nuk duket se e kupton: historia amerikane nuk ka të bëjë vetëm me “guximin e palëkundur”, siç e titulloi Stephen Ambrose librin e tij për eksploruesit e mëdhenj Meriwether Lewis dhe William Clark.

Ajo ka të bëjë gjithashtu me vlera morale si bujaria, toleranca dhe shpresa. Këto janë cilësitë që kanë frymëzuar botën të ndjekë udhëheqjen amerikane.

“Sytë e të gjithë njerëzve janë mbi ne,” thoshte Winthrop. Teksa anija e tij largohej nga Anglia drejt natyrës madhështore dhe lirisë që ofronte Amerika, ai i paralajmëroi shokët e tij se nëse do të adhuronin “perëndinë e rreme të kënaqësisë dhe fitimit,” atëherë “me siguri do të zhdukemi nga kjo tokë e mirë.” / bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

10 vjet nga pranimi i Kosovës në FIBA

Data 13 ishte me fat për basketbollin e Kosovës. Më 13 mars 2015 erdhi lajmi historik për pranimin e Kosovës në FIBA. Vendimi erdhi pas mbledhjes së

Komitetit Ekzekutiv të FIBA-s, që me votim unanim e pranoi Federatën e Basketbollit të Kosovës si anëtarin e vet të 215-të. Mbledhja ishte mbajtur në

shtëpinë e basketbollit në Gjenevë të Zvicrës. Pranimi erdhi pas shumë përpjekjeve për ndërkombëtarizim dhe një pune të madhe të bërë nga Federata e Basketbollit e

Kosovës. Ky lajm ishte një realizim i një ëndrre për të gjithë gjeneratat që kanë kontribuar në basketbollin e Kosovës me dekada të tëra. Më pas, basketbollistët/et e

Kosovës u pranuan në arenën ndërkombëtare, duke qenë të barabartë. Përfaqësueset e Kosovës marrin pjesë rregullt në garat evropiane, ashtu si edhe skuadrat e Kosovës.

Kampi Nacional në Hajvali do të bëhet me 14 mijë ulëse



“Epoka e re”

PRISHTINË, 13 MARS - Federata e Futbollit e Kosovës për herë të parë ishte nikoqire e një prej ngjarjeve të nivelit më të lartë ndërkombëtar. Të enjten është mbajtur mbledhja e Komitetit HatTrick të UEFA-s, në krye me Karl-Erik Nilsson, njëherësh zëvendës-presidenti i UEFA-s, ku të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e Komitetit HatTrick si Marie Coipel, Wojciech Cygan, Niccolo Donna, Kaarlo Kankkunen, Armen Melikbekyan, Muamed Sejдини, Zoltan Rosko, Samuel Scheidegger, Ane Guro Skaare-Rekdal si dhe zyrtarë të UEFA-s nga departamente për projektet investive dhe zyrtarë të FIFA-s. Takimi u hap nga kryetari i HatTrick, Karl-Erik Nilsson, i cili e falënderoi FFK-në për mikpritjen e ngrohtë, derisa presidentit Agim Ademi ia

dhuroi pllakën përuruese për ndërtimin e Kampit Nacional në Hajvali i cila është realizuar me mbështetjen e programit të UEFA-s, HatTrick. Presidenti i FFK-së, Agim Ademi, si nikoqir dhe anëtar i Komitetit, në fjalën e tij përshëndetëse falënderoi UEFA-n për bashkëpunimin e mirë, besimin e vazhdueshëm dhe në këtë rast për vlerësimin që Kosova të jetë nikoqire e një eventi kaq të rëndësishëm. Presidenti Ademi i falënderoi të gjithë anëtarët e Komitetit HatTrick për angazhimin dhe përkushtimin për zhvillimin dhe investimin në futbollin e Kosovës. “Gjatë takimit të mbajtur në ‘Hotel Emerald’ u prezantuan dhe shqyrtuan 22 projekte të paraqitura për aprovim në këtë Komitet nga federatat anëtare të UEFA-s. Kosova ka aplikuar me kërkesën për 14 mijë ulëse për stadiumin në Kampin Nacional në Hajvali. Ky projekt ka kaluar dhe bashkë me

projektet e tjera të ndryshme kanë marrë aprovimin për mbështetje nga programi HatTrick, njëherësh programi më i madh për zhvillimin e futbollit dhe solidaritetin”, thuhet në njoftimin e FFK-së. Anëtarët e Komitetit HatTrick të UEFA-s kanë arritur të mërkurën në Prishtinë dhe kanë vizituar ambientet e Shtëpisë të Futbollit, ku janë njohur me investimet që FFK-ja ka bërë në selinë e saj dhe janë takuar me stafin administrativ. Gjatë ditës delegacioni ka vizituar edhe Kampin Nacional në Hajvali projektin më të madh të FFK-së deri më tani, i cili është përkrahur fuqishëm nga programi HatTrick. Ata panë nga afër edhe punimet që po bëhen në stadiumin më të ri në Kosovë i cili do të jetë vatër e të gjitha ndeshjeve të Kombëtares. Kujtojmë se programi HatTrick tash e 21 vjet, ka financuar me mijëra projekte në vlera milionëshe.

SHKURT

Dalin në shitje biletat për ndeshjen Islandë - Kosovë në Murcia

Federata e Futbollit e Kosovës njofton opinionin se kanë dalë në shitje biletat për ndeshjen e kthimit të “play-off”-it të Ligës së Kombeve, ndërmjet Islandës dhe Kosovës, e cila zhvillohet më 23 mars në “Estadio Nueva Condomina” në Murcia të Spanjës. Tifozët “dardanë” që dëshirojnë ta ndjekin nga afër këtë përballje, duhet t’i blejnë biletat vetëm në sektorët e caktuar nga Federata e Futbollit e Islandës (sektorët 3 dhe 4), derisa çmimi është 30 euro. FFK-ja i fton të gjithë tifozët e Kosovës, të cilët kanë mundësi të jenë pjesë e kësaj ndeshjeje dhe ta mbështesin ekipin dardan drejt objektivit për promovim në Ligën B të Ligës së Kombeve.

Suhareka mposhti Feronikelin '74

Suhareka shënoi fitore në javën e 23-të në Superligën e Kosovës në futboll ndaj Feronikelit '74 me rezultat 2-0. Eneid Kodra kaloi vendasit në epërsi në minutën e 15-të pas krosimit nga Fitim Susuri. Për 2-0 u përkuajdes Liridon Fetahaj me gol në minutën e 59-të të takimit. Në minutën e 79-të, Lavdim Zumberi shënoi për 2-1, por ekipi nga Drenasi nuk arriti më shumë nga ky takim. Me këtë fitore, Suhareka shkon në kuotën e 29 pikëve në vendin e tetë dhe e vendos Llapin në pozitën e parafundit me tri pikë më pak. Në anën tjetër, Feronikeli '74 është i fundit me 13 pikë të grumbulluara dhe gati edhe matematikisht i ka humbur gjasat për mbijetesë.

Dafina Mustafa transferohet te skuadra e njohur zvicerane

Pivotja e Përfaqësueses së Kosovës, Dafina Mustafa, ka bërë lëvizje të rëndësishme në karrierë. 21-vjeçarja pas përfundimit të këtij edicioni do të transferohet nga Kreuzlingeni te skuadra më e madhe zvicerane, Yellow Winterthuri. Mustafa është zhvilluar te LC Bruhl, ndërsa në verën e kaluar iu bashkua Kreuzlingenit në Superligën e Zvicrës. Winterthuri aktualisht është në vendin e dytë në kampionatin zviceran. Dafina është shquar me paraqitje të mira te Kruezlingeni, sidomos në mbrojtje. Ajo tashmë është lojtare shumë e rëndësishme edhe e Kombëtares sonë. U shqua sidomos në ndeshjet me Belgjikën dhe Bosnjë-Hercegovinën, vjeshtën e kaluar. Dafina Mustafa ka thënë se ka synim ta ndihmojë skuadrën e re, por në të njëjtën kohë të dëshmojë që është e vlefshme për Kombëtaren e Kosovës. Edhe te Winterthuri janë shprehur të lumtur që kanë angazhuar lojtaren tonë. Yellow Winterthuri po lufton për titull të kampionit në Zvicër.

Katër skuadra për trofeun e Ligës Unike

Pas përfundimit të xhiros së gjashtë në Ligën Unike, janë përcaktuar katër skuadrat që do të luftojnë për titullin e kampionit. Final 4 i Ligës Unike te meshkujt zhvillohet

në Kosovë, derisa vendi i zhvillimit të eventit do të vendoset shumë shpejt nga Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës. Në gjysmëfinale janë kualifikuar

tri skuadra nga Kosova dhe një nga Shqipëria. Vëllaznimi, si lider i Grupit A, do të përballlet me Golden Eagle Yllin nga Grupi B, ndërkohë që Sigal Prishtina

do të ndeshet me Besëlidhjen. Ndeshjet gjysmëfinale zhvillohen më 26 mars, derisa ndeshja për vendin e tretë dhe finalja më 27 mars. Më 26 mars takohen

Vëllaznimi-Golden Eagle Ylli dhe Sigal Prishtina-Besëlidhja, kurse një ditë më vonë ndeshen ekipet për vendin e tretë dhe ndeshja finale.

Hamiltoni, gati për debutimin me Ferrarin: Kam ardhur për trofe dhe titujt kampionë

MARANELLO, 13 MARS - Edhe pse për Lewis Hamiltonin nuk është hera e parë që nis një sezon të Formulës 1, kjo do të jetë hera e parë për të si një pilot i Ferrarit. Shtatë herë kampioni i botës është gati për debutimin e tij me “kokëkuqen” në garën e parë sezonale që do të zhvillohet këtë fundjavë në Australi. Në

Melburn, në konferencën për shtyp, ai ishte “ylli më i kërkuar” nga mediet. Piloti veteran u shfaq shumë i sigurt në vetvete, i bindur për vlerën e shtuar që mund t’i sjellë makinës italiane dhe aspak i shqetësuar nga vëmendja e madhe mediatike që do të rrethojë këtë dyshe të pabesueshme.

“Mendoj se me kalimin e viteve presioni që i kam bërë vetes ka qenë gjithmonë 10 herë më i madh se çdo presion që dikush tjetër mund të më bëjë. Unë nuk erdha në këtë ekip për ta ndier presionin, por për rezultate, për trofe dhe titujt kampionë”, u shpreh Hamiltoni. “Unë kam

pritshmëri për veten time. Unë e di se çfarë mund të sjell, e di që mund të arrij rezultate. Unë e di se çfarë duhet për ta bërë këtë gjë realitet. Është vetëm një çështje që ta ulësh kokën dhe të punosh. Unë hyj në këtë fundjavë me një mendje shumë të hapur”, ka shtuar Hamiltoni.



Besfort Zeneli: Gjithmonë kam ëndërruar të luaj për Suedinë

STOKHOLM, 13 MARS - Besfort Zeneli dikur ishte pjesë e Përfaqësueses U21 të Kosovës në futboll. Aty qëndroi shkurt dhe më pas e braktisi vendin e prindërve të tij, për të cilin tha se nuk do të luante më. E tash, mesfushori thotë se në mendjen e tij gjithmonë ka qëndruar Suedia, aty ku është lindur dhe rritur. 22-vjeçari nuk i ndoqi hapat e vëllait të tij, Arbër Zenelit, i cili qe një kohë të gjatë është pjesë e “dardanëve”. Futbollisti i Elfsborgut u ftua nga selektori Jon Dahl Tomasson për miqësoret e marsit dhe ai e sheh veten në qiellin e shtatë pasi e realizoi ëndrrën e kamotshme. “Ishte një lajm shumë pozitiv. Trajneri Tomasson ma shpjegoi situatën dhe se çka po mendonte. Folëm se si e sheh futbollin dhe si më sheh mua. Më tha se më kishin ndjekur prej kohësh dhe se iu pëlqente ajo që e shihnin tek unë. Pastaj më tha se llogariste në mua për ndeshjet e marsit. Ishte paksa tronditëse



dhe e papritur për mua, mbi të gjitha ishte tepër argëtuese. Një ndjenjë shumë e këndshme për mua. Gjithmonë kam ëndërruar të luaj për kombëtaren suedeze”, ka deklaruar Besfort Zeneli për mediumin suedez “GP”. Menaxheri i Kombëtares suedeze, Stefan Pettersson, ka dhënë indikacione të qartë se Zeneli e ka zgjedhur Suedinë. Ndryshe nuk do të ishte

përzgjedhur në listë. Kemi folur shumë me të dhe për qëndrimin e tij për të luajtur për Suedinë.” Nuk ka dyshime dhe nuk ka pasur kurrë më parë tek ai. Nëse do ta përfaqësonte një kombëtare, do të bënte me kënaqësi për Suedinë”, ka theksuar Pettersson. Suedia do të luajë më 22 mars me Luksemburgun dhe më 25 mars me Irlandën e Veriut.

Oklahoma triumfon në fushën e Bostonit, zhgënjejnë Miami, Denveri dhe Dallasi

BOSTON, 13 MARS - Oklahoma arriti një fitore të rëndësishme në fushën e rivalëve të Bostonit me shifrat 118-112, duke mbrojtur kreun e renditjes në Konferencën e Perëndimit. Ndeshje e ekuilibruar deri në fund, ku vendimtar ishte Alexander Shai me 34 pikë, mbështetur edhe nga Holmgren me 23 pikë. Jashtë fushës fitoi skuadra e clippersave, që mundi me shifrat 119-104 Miamin. Treshja Bogdanoviq-Zubaq-Harden realizuan 80 pikë, duke bërë dallimin në fushë. Zhgënjeu ekipi i Denverit, që u mund me shifrat 115-94 në shtëpi nga Minnesota. Për miqtë u dalluan Edwardsi me 29 pikë e Randle



me 25 pikë. Fitoi edhe San Antonio, që mundi me rezultat 126-116 Dallasin, duke shpresuar për një vend në “play-off”. De’Aron Fox me 32 pikë

ishte lider në fushë. Skuadra e Houstonit, falë 29 pikëve të Jalen Green, mundi me rezultat 111-104 Phoenixin, ndërsa Atlanta triumfoi me rezultat 123-110 ndaj Charlottes, ndeshje ku u dallua Trae Young me 35 pikë.

REZULTATET	
Atlanta - Charlotte	123-110
Boston - Oklahoma	112-118
Toronto - Philadelphia	118-105
Houston - Phoenix	111-104
Memphis - Utah Jazz	122-115
Miami - Clippers	104-119
San Antonio - Dallas	126-116
Denver - Minnesota	95-115
Portland - New York	113-114

SHKURT

Rocco Vata ia shuan shpresat Shqipërisë, ftohet nga Irlanda

Rocco Vata nuk do të jetë pjesë e Kombëtares së Shqipërisë. I biri i ish-futbollistit shqiptar Rudi Vata është përfshirë në listën e të ftuarve të Irlandës për ndeshjet e marsit. Shqipëria kishte ende shpresa, por lista e sotme e irlandezëve i hoqi krejt dilemat dhe tash dihet qartë qëndrimi dhe vendimi i Vatës junior. Kështu mbyllen krejt rrugët që e çonin futbollistin te Kombëtarja shqiptare. 19-vjeçari është lindur në Skoci, ndërsa deri tash ka qenë pjesë e ekipit të të rinjve të Irlandës. Ai luan te Watfordi në Angli.

Simeone: Kush e pa Alvarezin duke e goditur topin me të dyja këmbët?

Trajneri i Atletico Madridit, Diego Simeone, është ndarë i kënaqur me paraqitjen e futbollistëve të tij në ndeshjen ndaj Real Madridit. Trajneri argjentinas është shprehur i zhgënjyer në lidhje me vendimin e anulimit të golit të Alvarazit nga penalltia. “Nuk e kam parë kurrë VAR-in të intervenojë për ta rishikuar një penallti në këto rrethana. Ju që jeni këtu prezent, cili prej jush e ka parë Alvarezin duke e prekur topin dy herë ju lutem ta ngrehë dorën. Unë nuk e kam parë”, ka thënë Simeone. “Jam krenar me djelmoshat e mi dhe i kënaqur me mënyrën se si luajtën. Edhe pse nuk arritëm të fitonim, i vumë në vështirësi kundërshtarët tanë. U përballëm me një skuadër që ka lojtarë të mëdhenj dhe e kontrolluam mirë lojën. Kjo natë do të mbetet në kujtesë të kundërshtarëve tanë, të cilët do ta kujtojnë se sa e vështirë ishte për t’u përballur me ne”, ka shtuar Simeone.

Ancelotti: Penalltitë janë lotari, Alvarazi e preku topin me dy këmbët

Trajneri Carlo Ancelotti ka folur pas kualifikimit të Real Madridit në çerekfinale të Ligës së Kampionëve. Reali e mposhti me penallti Atleticon, derisa trajneri italian ka thënë se Alvarazi e ka prekur topin me të dyja këmbët dhe se penalltitë janë lotari. “Ishte një ndeshje e vështirë, pasi na shënuan që në minutën e parë, ai gol ndryshoi edhe dinamikën e ndeshjes. Ndaj Atleticos është e vështirë të krijosh raste të pastra pasi ato mbrohen në një mënyrë të shkëlqyer. Penalltia e anuluar e Alvarazit? Është pak e çuditshme, por është e qartë që ai e preku topin dy herë, fillimisht me të djathtën dhe më pas me të majtën. Gjithsesi, penalltitë janë një lotari, këtë e dimë të gjithë”, u shpreh Ancelotti.

Kimmich rinovon kontratën me Bayernin

Më në fund është zyrtare, Joshua Kimmich ka rinovuar kontratën me Bayern Munchenin. Ka qenë vetë klubi “bavarez” që vetëm pak më parë ka publikuar lajmin se mesfushori i kombëtares gjermane ka vendosur të vazhdojë ta mbajë veshur fanellën e “bavarezëve” deri më 2029. Një lajm shumë i mirë ky për tifozët e Bayernit në prag të nisjes së fazës më të nxehtë dhe më vendimtare të sezonit.

Arteta paralajmëron Realin: Arsenali është i aftë të arrijë në gjysmëfinale

Pas kualifikimit në çerekfinale të Ligës së Kampionëve, skuadra e Arsenalit do të përballlet me kampionët në fuqi të Real Madridit. Një përballje e vështirë për “topçinjtë” që kanë mision ta eliminonjë skuadrën që e ka këtë

turne të preferuarin e tij. Trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta, u bëri thirrje lojtarëve të mos kenë frikë të ndërmarrin hapin tjetër në Evropë pavarësisht rivalit që kanë përballë. “Ne duhet të vlerësojmë këtë arritje të madhe që po bëjmë

në Evropë”, ka thënë Arteta. “Ne kemi bërë vazhdimisht lojëra të mira në Ligën e Kampionëve dhe tani duam të bëjmë hapin tjetër, i cili do të jetë shumë i vështirë. Gjithsesi, ne jemi shumë të aftë për ta bërë këtë gjë, për të

shkuar në gjysmëfinale”, ka shtuar Arteta. “Për ne Liga e Kampionëve është e rëndësishme sepse ne duam ta fitojmë atë. Jemi një klub që dëshiron të jetë më i miri në Evropë dhe dëshiron të konkurrojë me klubet më të mira

në botë. Për ta bërë këtë, duhet të jesh vazhdimisht aty, të luftosh me më të mirët. Është shumë e vështirë, por ne e kemi bërë për dy vjet rresht dhe kemi kapacitetin dhe aftësinë për ta bërë edhe më mirë”, ka përfunduar Arteta.



Gjei PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjei Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë





www.facebook.com/gjeipuneshpejte


RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica

NPL - "Qendra Multifunkionale" SH.A.



NPL "Qendra Multifunkionale" SH.A, në bazë të Ligjit të punës Nr.03/L-212 i shpallur në gazeten zyrtare të Republikës së Kosovës/Prishtinë: VITI V / Nr.90 / 01 Dhjetor 2010, si dhe në bazë të udhëzimit Administrativ Nr.01/2024, për Rregullimin e procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Kryeshefi Ekzekutiv merr vendim.

VENDIM

ANULOHET: Konkursi i shpallur me dt:11.03.2025, për pozitën Përgjegjës për Palestër Sportive NPL "Qendra Multifunkionale" SH.A-Mitrovicë.

Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë.

ARSYETIM

NPL "Qendra Multifunkionale" SH.A, pas shpalljes së Konkursit Publik të dt:11.03.2025 për pozitën Përgjegjës për Palestër Sportive, me arsyetimin se në Konkursin e Shpallur nga NPL "Qendra Multifunkionale" SH.A-Mitrovicë me dt: 11.03.2025 nuk janë përfshirë disa përmbajtje të konkursit të nenit 7 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2024

Mitrovicë
Dt: 13.03.2025



Muhamet Sylejmani
Kryeshef Ekzekutiv

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Getoar Selimi me nr. 600877502 Prishtinë, shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr: 330414897.
- Kristian Marashi B.I. nga Gjakova shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues: 811147603 të lëshuar nga ARBK.
- Lufton Berisha nga Dejn Rahovec shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "12 Maji" Ratkoc Rahovec.
- Shkelzen Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat ekl. 10.11.12.13 dhe diplomën e sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.
- Doli SH.P.K. nga Gjakova shpall të pavlefshme nr. Fiskal 812041961 të lëshuar nga ARBK.
- T.D.A.P. SH.P.K. nga Gjakova shpall të pavlefshme nr. Unik Identifikues 811125881 të lëshuar nga ARBK.
- Zoje Karaqi Doblibare Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesat e sh.m.u. "Dëshmorët Lleshi" Doblibare Gjakovë nga kl. 1-8.
- Teuta Pula nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Benita Thaqi nga Xërxe Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Krenar Gazija nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Hasan Arifi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX sh.f.m.u. " 28 Nëntori " Brodosan.
- Fatlind Imeraj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI- IX sh.f.m.u. " Dëshmoret e Hasit" Kabash i Hasit.
- Esmir Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat Q.K "11 Marsi" Prizren.
- Vahid Cocaj shpall te pavlefshme dëftesat sh.f.m.u. " Zenun Cocaj " Gjonaj.
- Dashurije Osmankaj shpall te pavlefshme dëftesat sh.f.m.u. " Pjeter Budi " Lubizhd e Hasit.
- Lirije Pajaziti shpall të pavlefshme Licencën e Punës të lëshuar nga Oda e Infermierëve të Kosovës me nr. KO-8808-05-21. Motër e Anestezionit.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

